

Saari në Gazetën shqiptare (17.2.19)



“Milosao” e këtij numri mund të konceptohet si një botim relativisht i ngushtë sa i përket tematikave, pasi kishte vetëm tre argumente. E para, i kushtohej Rami Saarit, një hebreu, që përkthen direkt nga shqipja, por edhe njëkohësisht poliglot i jashtëzakonshëm, njohës i mirë i shumë gjuhëve njëkohësisht. Dr. Jorina Kryeziu me skrupulozitetin e saj profesional na e kishte sjellë të plotë idenë e shfaqjes së plotë dhe të qartë të gjithë veprimtarisë së tij, që përgatit, por edhe sjellë shumë autorë nga Shqipëria në këtë vend. Urojmë që të jetë i skeduar nga shqiptarët si mik i vendit. Përkthimi i letërsisë sonë në gjuhën hebraike përbën njohjen e saj në një areal të veçantë dhe të paktë, në sasinë e përkthimeve, krahasuar me gjuhët e tjera që është përkthyer ajo, ku mbizotëron përkthimi prej gjuhëve të familjes indoevropiane. Me nismën e tij vetjake, ka bërë të mundur që letërsia shqipe të njihet në këtë areal me një numër të konsiderueshëm autorësh, shkroi Dr. Kryeziu.

I jemi mirënjohës layout sepse arriti që bibliografinë ta kishte në origjinal në hebraisht, një përpjekje e bukur por jo shumë e dashur nga njeriu jonë i grafikës që e lodhi pak. Autorja na ka propozuar edhe një intervistë me të.

Argumenti numër dy i takonte Suzana Roberts. Ajo është poetë dhe shkrimtare, përkthyesë dhe veprimtare për kulturën e paqes, nga Argjentina. Jeton në Trelew- Chubut dhe së fundi mori titullin që jepet nga Cmimi Ndërkombëtar “Atjon Zhiti”. Poezitë, që shoqëruan shkrimin, ishin të realizuara dhe i jemi mirënjohës dhe zotit Visar Zhiti, që pranoi të bashkëpunonte dhe të ndante këto poezi. Autorja e poezive ishte e mrekulluar gjithashtu me krijimtarinë në faqet e “Milosao”. Redaktori zgjodhi si përballje të tij një gjë të jashtëzakonshme, e cila lidhej me një apel që ai bëri për Amfiteatrin e Durrësit, një sfidë e kahershme, që ajo të zbulohet përfundimisht. Pak donkishoteske, por është e bukur nëse do të pranohej. Të shohim sesa do të bëhet. Numri ishte relativisht i mirë.